



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar / Prilijeno / Prodato / Received / Delivery	06.03.2023	3	viti / god / year
Organ / Njesia / Organ / Jedinica / Org. / Unit	Nr Prot / Br Prot / Prot No	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKIPNESHCK	2390	2023	116



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.39/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.39/2023 të datës 10.01.2023 të parashtruar nga ankuesja _____ kundër organit të punësimit/Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 06.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.39/2023 e datës 10.01.2023 e parashtruar nga ankuesja _____ :

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.Port: 7838/22 i datës 22.12.2022 i Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

A r s y e t i m

Ankuesja _____ me datën 10.01.2023, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar nën shenjen A.nr.39/2023 me numër protokoll 127/2023, kundër Vendimit Nr.Prot.7838/22 të datës 22.12.2022 i nxjerrë nga Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë procedurës së lëvizjes Brenda kategorisë për pozitën Zyrtar për Buxhet dhe Financa 2, e zhvilluar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 06.01.2023 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Ndërsa më datën 25.01.2023, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Me datën 21.02.2023, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK/2023 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankueses edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 127/2023 e datës 10.01.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 12.12.2022 për kandidatin fitues; Njoftimin e datës 22.12.2022 për kandidatin fitues; Njoftimin e datës 16.11.2022 lidhur me listën e ngushtë; Njoftimin e datës 24.11.2022 lidhur me verifikimin paraprak të kandidatëve; Diplomën e ankueses me numër Nr.2326 të datës 24.09.2020 Universiteti i Prishtinës-Hasan Prishtina, Fakulteti Ekonomik; Diplomën e ankueses me numër Nr.4615 të datës 15.09.2014 Universiteti i Prishtinës-Hasan Prishtina, Fakulteti Ekonomik; Akt emërimit të datës 27.08.2019; Njoftimin përmes E-mailit zyrtar të datës 12.12.2022; Njoftimin përmes E-mailit zyrtar të datës 30.11.2022; Njoftimin përmes E-mailit zyrtar të datës 16.11.2022; Konkursin me numër reference RN00010171 të datës 18.10.2022; Vendimin Nr.Prot.7838/22 të datës 22.12.2022 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë; Ankesën e ankueses e parashtruar tek NJBNJ; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 16.01.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 25.01.2023 nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës; Deklaratën me Nr.Prot.312/23 të datës 24.01.2023; Njoftimin përmes e-mailit zyrtar të datës 16.11.2022 E-mailat zyrtar të datës 19.12.2022; Pyetjet e intervistës me gojë të datës 05.12.2022; Listën me renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 12.12.2022 e gjeneruar tek SIMBNJ; Vendimin Nr.7244/22 të datës 25.11.2022 lidhur me formimin e komisionit për vlerësim; Njoftimin përmes e-mailit zyrtar të datës 30.11.2022; Njoftimin përmes e-mailit zyrtar të datës 16.11.2022; Listën e aplikantëve e gjeneruar tek SIMBNJ; Aplikacionin e kandidates së përzgjedhur të datës 08.11.2022; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të datës 26.01.2022 për kandidaten e përzgjedhur; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të datës 21.01.2021 për kandidaten e përzgjedhur; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të datës 17.12.2019 për kandidaten e përzgjedhur; Vërtetimin e datës 07.11.2022 për kandidaten e përzgjedhur lidhur me masën disiplinore; Akt emërimit të kandidates së përzgjedhur të datës 04.09.2018; Certifikatat e trajnimeve; Diplomën me numër Nr.2873 të datës 01.11.2019 nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"-Fakulteti Ekonomik të kandidates së përzgjedhur; Diplomën Nr.2498 të datës 10.07.2012 nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"-Fakulteti Ekonomik të kandidates së përzgjedhur; Kopjen e letërnjoftimit të kandidates së përzgjedhur M.A.V; Aplikacionin e ankueses të datës 07.11.2022; Diplomën me numër Nr.4615 të datës 15.09.2014 nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"-Fakulteti Ekonomik të ankueses; Diplomën me numër Nr.2326 të datës 24.09.2020 nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"-

Fakulteti Ekonomik; Letër referencën e datës 26.04.2014 për M.A-V; Autorizimin e datës 03.03.2014 për ankuesen; Marrëveshjet për shërbime speciale të ankueses të datave 21.08.2017, 03.04.2018, 24.09.2018, 01.04.2019, Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Certifikatën e evidencës penale me numër PN.2820/2022 të datës 17.06.2022; Vërtetimin e datës 04.11.2022 të ankueses lidhur me masën disiplinore; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të datës 24.01.2022 për ankuesen; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë të datës 26.01.2021 për ankuesen; Shpalljen e procedurës së rekrutimit në fjalë tek SIMBNJ; Vendimin Nr.Prot.6040/22 të datës 11.10.2022 lidhur me fillimin e procedurës së rekrutimit në fjalë si dhe Rezultatet e vlerësimit të intervistës me gojë të gjeneruara tek SIMBNJ.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses _____, është e pabazuar, **SEPSE:**

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji i Këshillit, konstaton se Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me datën 18.10.2022 ka publikuar njoftimin për shpallje të konkursit me Nr.Reference:RN00010171 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Zyrtar për buxhet dhe financa 2", ku afati për aplikim ka qenë nga data 02.11.2022-09.11.2022. Në këtë konkurs ka aplikuar dhe ankuesja e cila është përfshirë në fazat e procedurës. Me rastin e përfundimit të procedurës Komisioni i Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë ka bërë vlerësimin e kandidatëve në këtë proces dhe në bazë të formularit të renditjes përfundimtare të kandidatëve të datës 12.12.2022 ankuesja është vlerësuar me 78.6 pikë dhe është renditur e dyta me pikë ndërsa kandidatja A.V është vlerësuar me 91 pikë, ndërsa pas njoftimit individual të datës 12.12.2022 ankuesja është njoftuar për rezultatin përfundimtar.

Ankuesja kundër këtij vlerësimi me datën 17.12.2022 ka parashtruar ankesë tek Divizioni i Burimeve Njerëzore të kësaj ministrie, ndërsa Komisioni për Lëvizjen Brenda Kategorisë me datën 22.12.2022 ka nxjerrë Vendimin Nr.Prot.7838/22 sipas të cilit ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka ushtruar ankesë kundër Vendimit Nr.Prot.7838/22 të datës 22.12.2022 lidhur me procedurën për pozitën e lartcekur, me arsyetimin se ky vendim është i njëanshëm dhe i padrejtë.

Në bazë të konkursit me Nr. Reference:RN00010171 të datës 18.10.2022 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Zyrtar për buxhet dhe financa 2", kërkesat e përgjithshme formale kanë qenë: "Arsimi i kërkuar: Diplomë të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to nga Fakulteti Ekonomik. Përvoja e punës e kërkuar: "Së paku dy (2) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës".

Në kuptim të vendosjes meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkitazi me procedurën e rekrutimit të lartcekur, gjegjësisht Kolegji analizoj:

Nenin 38 paragrafin 1 dhe 2, me të cilin është përcaktuar se: "1. Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për

vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni”.

Nenin 38 paragrafin 5 dhe 6, me të cilin është përcaktuar se: “5. Vlerësimi i kandidatëve të interesuar kryhet nga një komision vlerësimi, i krijuar në çdo institucion, bazuar në një intervistë me kandidatët. Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë, njëri nga të cilët është domosdo përfaqësues i Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit. 6. Në përfundim të vlerësimit, Komisioni mund të vendosë: 6.1. përzgjedhjen e kandidatit më të suksesshëm për t’u emëruar në vendin e lirë, apo; 6.2. përfundimin e procedurës, pa asnjë të përzgjedhur, në rast se asnjë nga kandidatët e interesuar nuk vlerësohet i suksesshëm për atë vend të lirë të punës.”.

Po ashtu Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht:

Nenin 44 paragrafi 1 dhe 2, me të cilin është përcaktuar se: “1.Konkurimi për lëvizjen brenda kategorisë zhvillohet në dy faza: 1.1. verifikimi paraprak i kandidatëve; dhe 1.2. vlerësimi i kandidatëve. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ, ndërsa vlerësimi i kandidatëve kryhet nga Komisioni i Vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, krijuar sipas nenit 47 të kësaj Rregulloreje”

Nenin 45 paragrafit 1, 2 dhe 3, me të cilin është përcaktuar se: “1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurohet. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak NJBNJ përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lire. Vetëm këta kandidatë kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin”.

Nenin 47 paragrafin 1, 2, 3 dhe 4, me të cilin përcaktohet se: “1.KVLBK zhvillon një intervistë me gojë me kandidatët. 2.Nëpërmjet intervistës, KVLBK vlerëson jetëshkrimin/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurimi. 3.KVLBK përgatit përpara fillimit të intervistës një grup pyetjesh. Intervista që zhvillohet është e strukturuar dhe me pyetje të njëjta për të gjithë kandidatët e cila përgatitet në ditën e zhvillimit të intervistës.. 4.Vlerësimi maksimal në intervistën me gojë është njëqind (100) pike”.

Nenin 48 paragrafin 1 dhe 2, me të cilin përcaktohet se: “...Pikët e çdo anëtari për çdo vlerësim mbliidhen dhe pjesëtohen me pesë. 2.Në përfundim të fazës të vlerësimit, pikët e përfituara nga secili kandidat në secilën nga hapat e vlerësimit, mbliidhen dhe shumta e pikëve për të gjithë hapat e vlerësimet përbën vlerësimin përfundimtar të konkurimit”.

Nenin 49 paragrafin 1, 2 dhe 3, me të cilin përcaktohet se: “1.KVLB në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njesisë Përgjegjëse brenda njëzetë e katër (24) orëve nga miratimi i saj. 2.Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurimi. 3.Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar me gjashtëdhjetë 60 e më shumë pikë, procedura e lëvizjes brenda kategorisë përfundon pa kandidat fitues”.

Andaj bazuar në dispozitat e lartcekura, Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda Kategorisë, vlerësimin e intervistës me gojë për kandidatët në këtë

proces e ka bërë në pajtim me dispozitat e lartcekura, rrjedhimisht ankuesja nga komisioni është vlerësuar me gjithsejtë 78.6 pikë ndërsa kandidatja tjetër është vlerësuar me 91 pikë, në këtë rast kandidatja ka qenë konkurrense fituese dhe meqë ka pasur numër më të madh të pikëve atëherë edhe emërimi në pozitë bëhet duke filluar nga kandidati që ka numrin më të madh të pikëve, ndërsa si rezultat i vlerësimit të tërësishëm të kësaj procedure, Kolegji i këshillit, konstaton se nuk është evidentuar ndonjë shkelje procedurale dhe nuk është dëshmuar me asnjë provë që ankueses i është cenuar ndonjë e drejtë në vlerësim të intervistës më gojë, sepse ankuesja po ashtu edhe kandidatja kanë plotësuar të gjitha kërkesat e konkursit dhe të gjitha ato që janë kërkuar sipas Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka analizuar pretendimet ankimore të ankueses, lidhur me atë se ka ekzistuar konflikti i interesit për shkak të lidhjeve familjare në mes të kandidatëve e anëtarëve të komisionit si dhe stafit drejtues të kësaj ministrie dhe ka konstatuar se, ankuesja me asnjë dëshmi të vetme nuk ka arritur të vërtetojë se ka ekzistuar konflikti i interesit i pretenduar si dhe e njëjta ka dështuar të provojë këtë rrethanë, nga se legjislacioni e rregullon çështjen e konstatimit të konfliktit të interesit, procedurën dhe organin që konstaton këtë fakt apo çështjen e kryerjes së detyrave të kandidatës së përzgjedhur në emër të Udhëheqësit të Divizionit për Buxhet dhe Financa pranë kësaj ministrie. Po ashtu ankuesja pretendon se Udhëheqësi i Divizionit për Buxhet dhe Financa pranë kësaj ministrie, ka qenë duke e ushtruar detyrën e Zyrtares Kryesore Financiare dhe i njëjti në zyrën e tij e ka marrë kandidaten e përzgjedhur afër tij në zyrë duke ia mësuar punën dhe duke e lënë që me user të tij ti kryej pagesat. Ndërlidhur me këtë rast Kolegji i Këshillit ka konstatuar po ashtu se, Udhëheqësi i Divizionit për Buxhet dhe Financa pranë kësaj ministrie, në përgjigjen në ankesë e dhënë për Udhëheqësen e Divizionit të Personelit pranë kësaj ministrie përmes deklaratës me Nr.Prot. 312/23 të datës 24.01.2023, ka deklaruar se", citoj:" *Ndërsa lidhur me kandidaten e përzgjedhur nuk kam lidhje familjare dhe asnjëherë nuk ka bërë aprovimin e pagesave me user timin*", prandaj edhe pretendimet ankimore të ankueses në këtë drejtim janë të pabazuara dhe jo ligjore.

Lidhur me ligjshmërinë e Vendimit me Nr.Port: 7838/22 të datës 22.12.2022 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Kolegji i Këshillit, konstaton se ky vendim është nxjerrë në pajtim me nenin 50 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim me nenin 47 dhe nenin 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që të gjitha pretendimet ankimore të ankueses janë të pabazuara.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.39/2023, datë 06/03/2023.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.